

Zhvillohet seanca dëgjimore online me Komisionin për Politikën e Jashtme për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”



U zhvillua seanca dëgjimore online me Komisionin për Politikën e Jashtme. Në këtë seancë morën pjesë ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe drejtoreshat ekzekutive: znj. Sonila Hysi nga Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD), znj. Mimoza Hysa nga Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD), znj. Majlinda Vogli nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD), si dhe znj. Diana Kastrati nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA). Gjatë kësaj seance u diskutua projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” akorduar për Ministrin e Shtetit për Diasporën. Misioni i Ministrisë të Shtetit për Diasporën është të përfaqësojë dhe të nxisë politikën e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë. Drejtueset e institucioneve të diasporës, të cilat mbështesin misionin e Ministrisë të Shtetit për Diasporën duke ndihmuar dhe kontribuar konkretisht në çështje që lidhen me Diasporën, njohën anëtarët e këtij komisioni me projekt-buxhetin për institucionet përkatëse.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

QBD / Kuteli përkthehet në pesë gjuhë të huaja



Qendra e Botimeve për Diasporën do të sjellë së shpejti botimin dygjuhësh në pesë gjuhë të veprës “Tregime të Moçme Shqiptare” të Mitrush Kutelit. Të gjithë e njohim rëndësinë e veprës së Kutelit për gjuhën shqipe, letërsinë shqipe, traditën dhe kulturën e madhe, sidomos në fushën e folklorit, ashtu siç thotë dhe vetë Kuteli të gjithë rapsoditë popullore, legjendat e moçme të rrëfyera tashmë si përralla për fëmijë. Deri tani ka munguar përcimi i gjithë kësaj diturie mbi trashëgiminë tonë popullore në gjuhë të tjera gjë që do të na identifikonte si një popull që kemi tregime të moçme të krahasuara, të barasvlershme me të gjithë pasurinë që kanë vendet e tjera. Në një intervistë të dhënë për “Në Tempull” drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, tregon për botimin dygjuhësh në pesë gjuhë të veprës së Mitrush Kutelit.

“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Zhvillohet mbledhja e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës



Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës mbajti ditën e sotme mbledhjen e radhës, e cila u drejtua nga kryetari i këtij Këshilli, z. Sokol Dedja, zv.ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë kësaj mbledhjeje, Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi prezantoi punën e realizuar deri tani nga Agjencia për vitin 2020 dhe parashikimin e objektivave për vitin 2021. Në vijim të takimit anëtarët e Këshillit kanë miratuar dy vendime si vendimi për miratimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitin 2021-2023 dhe vendimi për miratimin e kostos shtesë për oficerët koordinues për vitin 2020.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Botimi dygjuhësh shqip-italisht “Sirena e vogël” / “Udhëtimet e Guliverit”, falas nga QBD



Botimi dygjuhësh shqip-italisht “Sirena e vogël” / “Udhëtimet e Guliverit”, falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën “Sirena e vogël” dhe “Udhëtimet e Guliverit”, dy përralla mjaft të dashura për fëmijët, pjesë e serisë “Klasikët Dygjuhësh” – projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe italisht. “Sirena e vogël”, një ndër përrallat e famshme të shkruara nga autori danez Hans Christian Andersen, u botua për herë të parë në vitin 1837, si pjesë e një koleksioni përrallash për fëmijë. Është përshtatur në media të ndryshme, si: teatër muzikor, balet, opera dhe film. Ekziston edhe një statujë që portretizon sirenën në Kopenhagë, Danimarkë, ku historia u shkrua dhe u botua për herë të parë. Përralla “Udhëtimet e Guliverit” është një përshtatje nga vepra satirike me të njëjtin titull e shkrimtarit dhe klerikut irlandez Jonathan Swift, botuar më 1726. Konsiderohet si një klasik në letërsinë botërore për fëmijë dhe jo vetëm. Vepra pati një sukses të menjëhershëm që në krye të herës. Dramaturgu anglez John Gay u shpreh për veprën se libri “është lexuar botërisht, nga këshilli i kabinetit deri në çerdhe”.

D Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Itali / Vijon dorëzimi i librave për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporën shqiptare, dërguar falas nga QBD



Vijon dorëzimi i librave për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporën shqiptare në Itali, dërguar falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën, nën kujdesin Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë ka bërë shpërndarjen e teksteve mësimore dhe plotësuese për vitin shkollor 2020-2021 deri në veriu e Italisë. Së fundmi, librat kanë mbërritur në shkollën “Mësonjëtorja” në Brescia, e cila është gati për të vijuar mësimin e gjuhës shqipe online. Qendra e Botimeve për Diasporën ka dërguar falas 4479 tekste mësimore dhe plotësuese për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Itali. Tekste të ndryshme shkollore, seria më e re e botimeve dygjuhëshe nga Qendra e Botimeve për Diasporën, një sërë vlerash, materialeve të ndryshme didaktike janë tashmë në dispozicion të mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).